



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

RAPORTI I SHPENZIMEVE PER ZGJEDHJET E LOKALE NE KOMUNEN E PARTESHIT

GUSHT 2010

PËRMBAJTJA

Përkufizimet.....	3
HYRJE	4
NDARJET BUXHETORE	5
BUXHETI I PLANIFIKUAR DHE I SHPENZUAR PER ZGJEDHJET E LOKALE NE PARTESH	6
Paga dhe mëditjet	7
Mallra dhe shërbime.....	7
Shpenzimet komunale	8
PËRFUNDIM	9

Përkufizimet

KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
SKQZ	Sekretariati i Komisionit Qendror te Zgjedhjeve
MEF	Ministria për Financa dhe Ekonomi
LMFPP	Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
BBK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
KKZ	Komisioni Komunal i Zgjedhjeve
QNR	Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
QV	Qendra e Votimit
VV	Vend Votimi
KVV	Këshillat e Vend Votimit
€	Euro
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare te Kontabilitetit për Sektorin Publik
NLB	Banka NLB Prishtina

HYRJE

Me vendimin nr 316-2010 Presidenti i Republikës së Kosovës ka shpallur datën 20 qershor 2010 për mbajtjen e Zgjedhjeve të nivelit lokal në komunën e Parteshit .

Ligji nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ka paraparë strukturën, përgjegjësitë dhe funksionimin e KQZ-së si dhe të Sekretariatit të KQZ-së.

Neni 113.6. i këtij Ligji kërkon që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të përgatis dhe publikoj një raport të plotë për shpenzimet zgjedhore dhe mënyrën e shpenzimit të tyre për zgjedhje.

Andaj në bazë të obligimeve ligjore ne do të prezantojmë një raport detaj të shpenzimeve për Zgjedhjet e lokale në komunën e Parteshit për asamble komunale dhe për kryetar komune.

Raundi i parë i Zgjedhjeve për asamble komunale dhe për kryetar komune u mbajt me 20 qershor 2010. Pasi asnjëri nga kandidatët për kryetar komune në raundin e parë nuk fituan më shumë se 50% plus një votë të numrit të përgjithshëm të votave, KQZ-ja me vendimin nr 722-2010 organizoi raundin e dytë të Zgjedhjeve për kryetar të kësaj komune me 18 korrik 2010.

NDARJET BUXHETORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organizatë buxhetore, me kod organizativ 320 dhe me kod funksional 0170. KQZ-ja financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i organizuar në dy programe buxhetore:

- 141 Programi i Sekretariatit të KQZ-së i cili paraqet shpenzimet operationale
- 142 Programi i Zgjedhjeve i cili paraqet buxhetin e zgjedhjeve

Raporti është përgatitur në pajtim me LMFPP (03/L-48) dhe SNKSP dhe sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës së realizimit të shpenzimeve.

Bazë për hartimin e dokumentit kanë shërbyer raportet e SIMFK, të dhënat nga sektori i financave, dokumentet financiare si faturat, raportet e pranimit të mallit, kontratat si dhe dokumentet tjera të SKQZ-se.

Në raport janë të përfshira të dy programet: programi i Sekretariatit të KQZ-se dhe programi i Zgjedhjeve. Në shpenzimet buxhetore për Zgjedhjet lokale në komunën e Parteshit si dhe zgjedhjet e balotazhit për kryetar të komunës, janë të prezantuara shpenzimet e realizuara në muajin qershor dhe korrik e të cilat kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime, dhe shpenzimet komunale.

Në raport janë të prezantuara vetëm **shtesat** e muajit qershor për shërbyesit civil të SKQZ-se të angazhuar drejtpërdrejtë për periudhën zgjedhore (qershor dhe korrik) por jo edhe pagat e rregullta për anëtarët e KQZ-se dhe ato për shërbyesit civil të SKQZ-se.

Të gjitha pagesat janë bërë në sistemin e kesh-it (parave të gatshme) e jo të zotimit.

Valuta raportuese është euro (€)

Shumat raportuese janë në njësi në €

BUXHETI I PLANIFIKUAR DHE I SHPENZUAR PER ZGJEDHJET E LOKALE NE PARTESH

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ne mbledhjen e 23-te mbajtur me 5 mars 2010 për Zgjedhjet lokale ne komunën e Parteshit ka ndare buxhetin ne shume prej 193,606€

Buxheti i shpenzuar për zgjedhjet lokale është realizuar me korrektësi sipas zërave të shpenzimeve dhe me efektivitet duke treguar kujdes që fondet e miratuara të shpenzohen sipas planit në kohën e duhur dhe me një administrim ekonomik efektiv.

Realizimi i buxhetit, përkatësisht shpenzimet për Zgjedhjet lokale ne Partesh për periudhën qershor korrik duket kështu në vijim:

Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar për zgjedhjet ne Partesh

Tabela nr 1

në €

Kategoritë ekonomike	Buxheti I Planifikuar	Buxheti I Shpenzuar	Realizimi %
Shtesat për paga	6.600	6.600	100,0
Mallrat dhe shërbimet	175.206	91.062	52,0
Shpenzimet komunale	800	644	80,5
Rezerve	11.000	-	-
Total	193.606	98.306	50,8

Realizimi i buxheti përkatësisht shpenzimet për Zgjedhjet lokale ne Partesh kundrejt planit është bërë në masën %, pra nga 193,606€ të aprovuara, janë shpenzuar 98,306 €

Fondet e mbetura te pa shfrytëzuara te buxhetit për zgjedhjet lokale ne komunën e Parteshit janë 95,300 Euro te cilat kryesisht kanë të bëjnë me kategorinë buxhetore te mallrave dhe shërbimeve.

Paga dhe mëditjet

Qeveria e Republikës të Kosovës edhe në vitin 2010 ka ndarë buxhet shtesë KQZ-se në paga në vlerë 200€ në muaj për angazhimin e drejtpërdrejtë të një numri të caktuar të shërbyesve civil për Zgjedhjet e përsëritura, për Zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe për Zgjedhjet e rregullta në komunën e Parteshit.

Nga 200€ u paguan për angazhimin e 33 shërbyesve civil të SKQZ-se në zgjedhjet e lokale në komunën e Parteshit, çka do të thote se në qershor për paga shtese u shpenzuan 6,600€

Mallra dhe shërbime

Në mallra dhe shërbime, kanë qenë të planifikuara 175,206€. Këto mjete u shpenzuan në shumë prej 88,892€ apo buxheti është shpenzuar 50.7%. Këto shpenzime janë realizuar përmes dy formave:

- të aprovimeve
- të blerjeve-prokurimit.
-

Në tabelle janë të prezantuara shpenzimet e realizuara sipas kategorive dhe nënkategorive për zgjedhjet lokale në komunën e Parteshit.

Tabela nr. 2

në €

Kategoritë ekonomike	Total- shpenzimet Partesh
Paga dhe mëditje	6.600
Mallra dhe Shërbime	91.062
Shpenzimet e udhëtimit	4.200,25
Internet	1.628
Shpenzimet tjera telefonike vala900	100
Sherbime kontraktuese tjera	42.296
<i>Stafi jopermanent</i>	<i>12.279</i>

<i>Shërbimi votues</i>	2.270
<i>Fletëvotimet</i>	7.800,69
<i>Trajner</i>	500
<i>KKZ</i>	3.281
<i>Material zgjedhor</i>	490
<i>Qendra Alternative</i>	400
<i>Shtypja e disnktivave</i>	615
<i>KVV</i>	9.869
<i>Stafi QNR</i>	628
<i>QNR</i>	4.164
Furnizimi për Zyre	414
Furnizime ushqim dhe pije	2.200
Furnizim pastrimi	500
Karburant për vetura	1.063
Mirëmbajtja e teknike .informative	350
Qiraja për depo	5.496
Shpenzimet për informim publik	32.522
Drekat zyrtare	293
Shpenzimet komunale	644
Energji elektrike	644
Total	98.306

Ne kategorinë e mallrave dhe shërbimeve pjesëmarrje me te larte kane shërbimet tjera kontraktuese te cilat paraqesin 43% te shpenzimeve. Ne këto shpenzime janë te përfshira pagat e stafit jopermanent, pagat e KKZ-ve, pagat e trajnerëve, mëditjet e anëtarëve te KVV, mëditjet e stafit te QNR-se prodhimi i fletëvotimeve, materialit zgjedhor, qiraja e depos etj.

Shpenzimet komunale

Ndërsa nga 800€ te planifikuara për shpenzime komunale për këto zgjedhje, u shpenzuan 644€ apo 80.5% nga ato te planifikuara.

PËRFUNDIM

Në bazë të dhënave të SIMFK dhe data bazës të SKQZ-së mund të përfundojmë se për Zgjedhjet lokale në komunën e Parteshit për të dy raundet në komunën u shpenzuan **98,306€**

Paraqitja grafike e buxhetit të shpenzuar

